



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni pranveror

Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere
Mbledhja nr.17/24
Prishtinë, më 2.10.2024, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, Salla C-203

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Armend Muja, Kryetar, Mërgim Lushtaku, nënkryetar, Enver Haliti, Jeta Statovci, Eman Rrahmani, Avdullah Hoti, Pal Lekaj dhe Duda Balje, anëtarë.

Munguan: Ferat Shala dhe Visar Korenica, anëtarë.

Të ftuar: Hekuran Murati, ministër i MFPT, Emanuel Bajra, kryetar i Bordit, FKPK, Adrian Zalli, drejtor, FKPK, Mimoza Mustafa, anëtare e bordit, FKPK, Trim Shala, anëtar i Bordit, FKPK, Shpresim Vranovci, anëtar i Bordit, FKPK.

Pjesëmarrësit e tjerë: Festim Bytyqi, këshilltar, GP AAK, Sami Gashi, GP LVV, Elsa Krasniqi, GP LVV, Nexhmije Ahmeti - zyrtare për media, Kuvendi, Driada Thaqi, zyrtare për bashkëpunim, ZKA, Fjolla Haziri, praktikante, KDI, Anduena Shtavica, asistente GP LDK, Lulzim Kelmendi, KIF Evropiane, Egzona Terdevci, GP LVV, Munib Durguti, asistent Kuvend.

Stafi mbështetës i Komisionit: Sabrije Saliuki-Iseini, Luljetë Krasniqi, Dashurije Canolli dhe Frina Kabashi, Praktikante –D+.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 08/L- 031 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim;**

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së Fondit të Kursimeve Pensionale për vitin 2023;
4. Të ndryshme.

Kryetari, propozoi që të inkorporohen edhe disa pika të rendit të ditës, raporti për regjistrimin e pronarëve përfitues, raporti i Komisionit funksional për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve të veçanta për krijimin e bazës ligjore në nxjerrjen e akteve nënligjore nga Qeveria dhe raporti me rekomandime për harmonizimin e ligjeve për kundërvajtje.

Eman Rrahmani e kundërshtoi propozimin që rendi i ditës të plotësohet me pika shtesë, me arsyen se mungojnë materialet për pikat e propozuara.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Me shumicë votash, u miratua Rendi i ditës pa ndryshime.

2. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 08/L- 031 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim;

Kryetari, njoftoi komisionin se sipas pikës 74 paragrafi 2 të Rregullores të punës së Kuvendit, Komisioni për Buxhet si komision raportues shqyrton Projektligjin para shqyrtimit në parim dhe Kuvendit i rekomandon miratimin në parim.

Projektligji lidhet me prioritet dhe objektivat e Qeverisë të parapara në planprogramin e Qeverisë së Kosovës 2021-2025 dhe ka për qëllim ngritjen e qëndrueshmërisë ekonomike dhe për të prezantuar arsyeshmërinë e projektligjit.

Hekuran Murati, Ministër i MF

Sipas tij përmes projektligjit për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim synojnë ngritjen dhe forcimin e integritetit dhe transparencë të praktikave financiare duke i përafuar ato më ngushtë me standardet ndërkombëtare.

P/Ligji riformulon emërtimin e shoqatave profesioniste të kontabilitetit dhe auditimit si etnitete jofitimprurëse, joqeveritare që zbatojnë standardet e Federatës Ndërkombëtare të Kontabilitetit, e kjo siguron që praktikat kombëtare të përmbushin pritshmërinë globale, duke rritur besimin si në nivelin kombëtar ashtu edhe atë ndërkombëtarë në sistemin tonë financiar.

Si arsye tjetër për plotësim ndryshim, është kërkesa që subjektet tregtare të dorëzojnë raportet e tyre financiare në formën elektronike përmes një sistemi të aprovuar nga Këshilli i Kosovës për raportim financiar, duke theksuar se kalimi në raportimin digjital do të përmirësojë saktësinë dhe afatet e dorëzimit të deklaratave financiare.

Për të siguruar përputhshmërinë e vazhdueshme, ligji kërkon vlerësime të rregullta nga ekspertë ndërkombëtarë të shoqatave që nuk janë të lidhura me Federatën Ndërkombëtare të Kontabilitetit me frekuencën e këtyre vlerësimeve që varion në bazë të nivelit të tyre të asociimit me FNF.

Kjo do të ndihmojë në ruajtjen e standardeve më të larta të sjelljes profesionale brenda sistemit financiar.

Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) gjithashtu ka autoritetin të ndërmarrë veprime vendimtare, duke përfshirë edhe reduktimin e licencave ndaj shoqatave të cilat nuk i përmbushin standardet e kërkuara.

Gjithashtu, janë vendosur procedura të qarta për reregjistrimin e anëtarëve të prekur nga këto veprime, duke siguruar që ndërprerjet të jenë minimale.

Andaj duke pasur parasysh domosdoshmërinë e këtyre ndryshimeve, propozoi që Projektligji të votohet me miratim në parim.

Abdullah Hoti, duke konsideruar se disa nga diskutimet e ministrit nuk qëndrojnë, kërkoi sqarime lidhur me:

Paqartësitë me Memorandumin shpjegues të Projektligjit, në krahasimin e neneve të ligjit në fuqi dhe Projektligjit, përveç në 2-3 raste, në ligjin në fuqi kërkohet raportimi elektronik dhe fizik, ndërsa me projektligj kërkohet dorëzimi fizik dhe mbi këtë bazë projektligji do të degradoj nivelin e raportimit financiar.

Tek neni 2 i Projektligjit që lidhet me nenin 3 të ligjit në fuqi është hequr anëtarësimi në federatën e kontabilitetit dhe vetëm është ridefinuar se çka është një shoqatë jofitimprurëse dhe kjo nuk është standard ndërkombëtar.

Në nenin 3 të Projektligjit është hequr dorëzimi fizik i raportit.

Në nenin 4 pika 1.1 të Projektligjit është hequr anëtarësimi në Federatën Ndërkombëtare të Kontabilitetit.

Pika 2 e nenit 25 të ligjit në fuqi, aty kushtohen paragrafët, në paragrafin 2 do të lejohet të funksionojnë shoqata që nuk janë anëtare të FNK-së, ndërsa deri tani shoqatat që nuk kanë qenë anëtare të FNK-së në Kosovë nuk kanë mundur të funksionojnë.

Sipas Projektligjit, në pikën 3, Këshilli Kosovar për raportim financiar ka autoritet dhe mund të kërkojë për nevojat dhe mbikëqyrje, të kontrakttojë një organizatë apo shoqatë profesionale për ekspertizë financiare etj. Ky është një lloj diskrecioni se kush dhe si i përzgjedh këto organizata.

Në pikën 4 dhe 5, ku Këshilli i Kosovës për raportim financiar ndërmerr masa, kush e konstaton këtë? Neni 6 pika 11 e Projektligjit, tek revokimi i licencës apo pezullimi rregullohen me akt të veçantë të nxjerrë nga ministri i financave, pyeti se cilat janë ato çështje tjera?

Hekuran Murati, tha se synimi i plotësim ndryshimit të ligjit është përafrimi me legjislacionin e BE-së, ndërsa përafrimi i plotë në momentin e inkuadrimin në BE, e që deri atëherë lejohet që shteti të bëjë përafrime të pjesshme si në rastin konkret.

Sa i përket ripërkufizimit – Shoqata bëhet me qëllim që të jepet hapësirë për të shtuar konkurrencën e akterëve, e me të cilën pastaj shtohet cilësia.

Ndërsa, tek mënyra e dorëzimit të raporteve unifikimi, konsolidimi i një metode për raportim digjital e bën të mundshme që pastaj të gjitha kompanitë të bëjnë të njëjtin raportim.

Tek aktet nënligjore, fjala është vetëm për rastet e revokimit, do të thotë kjo është e kufizuar.

Mërgim Lushtaku, meqë pati reagime edhe nga Avokati i Popullit, për shkelje ligjore dhe kushtetuese për nenin 3 të projektligjit, ndryshimet janë bërë me të njëjtën logjikë, pse nuk janë inkorporuar komentet e Avokatit të Popullit dhe ndryshimet kur projektligji do të shqyrtohet në procedurat në mes të dy leximeve, duhet të dëgjohen edhe palët e tjera, shoqatat, grupet e interesit dhe të riformulohet neni 3 i projektligjit.

Hekuran Murati, pikërisht tani e kemi bërë këtë plotësim ndryshim që me konkurrencën e akterëve të mos ketë kufizime që nënkupton se nuk është e domosdoshme që shoqatat të jenë anëtare.

Kryetari, konstatoi që pas përfundimit të diskutimeve, Komisioni me shumicë votash nxori këtë:

Rekomandim

Të miratohet në parim Projektligji nr. 08/L- 031 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

3.Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së Fondit të Kursimeve Pensionale për vitin 2023;

Kryetari, njoftoi komisionin se në bazë të nenit 4.18, 5.2 dhe 5.3, të Ligjit nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115, Ligjin nr. 04/L-168 dhe Ligjin nr. 05/L-116, Bordi drejtues i Fondit Pensional të Kosovës është i obliguar që të paraqet në Kuvend raportin vjetor, jo më vonë se 5 muaj pas përfundimit të vitit kalendarik. Raporti duhet të përmbajë vlerën dhe proporcionalitetin e mjeteve pensionale të cilat janë investuar në klasa të veçantë të letrave me vlerë si dhe raportet për të gjitha pagesat e mbajtjes dhe shërbimet e transaksioneve financiare dhe raportet e audituara. Të ftuar kemi përfaqësuesin e Fondit të Kursimeve Pensionale z. Emanuel Bajra, nga i cili kërkojmë që të prezantojë dhe arsyetojë raportin në fjalë.

Emanuel Bajra, lidhur me raportin, tha se është publikimi më i rëndësishëm ku shpalosen të gjitha të dhënat dhe sqarimet e fushëveprimit, i njëjti përmban edhe të dhëna krahasuese për 2 vitet e fundit, të gjitha pasqyrat vjetore janë aprovuar nga auditori i jashtëm duke rezervuar në harmoni të plotë me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar

Çështja kryesore e raportit është performanca e investimeve, FKPK-ja për 19 vite ka shënuar rezultatet pozitive, performanca e portofolit standard u arrit nga përmirësimi i tregjeve makroekonomike -globale e kjo ka ndikuar në ngritjen e tregjeve financiare

Abdullah Hoti, pyeti për raportin e brendshëm për teknologjinë e informacionit,(sipas konstatimeve në raport, faqe 11) për llogaritë aktive që për 8 vite numri i kontribuuesve është i njëjtë, mungesa e 3 anëtarëve në bord , ndikimi në politikat investuese dhe investimet tjera, trajtimi i plasmanëve, kthimi nga investimet në Kosovë, pasivizimi i kontribuuesve dhe rënia e kontribuuesve ekuivalent?

Përfaqësuesi i FKPK-së u përgjigj, sa i përket kompozimit të bordit nga 13 korriku bordi është funksional, ka kuorumin dhe vendimet merren me konsensus, vlen të theksohet se nga ata që mungojnë njeri prej tyre nuk ka të drejtë vote

Për shtrirjen e investimeve, Kosova është pjesë e gjithë portofolios dhe është një raport i definuar mirë në mes institucionit si trust, aset menaxherëve tonë dhe tregut sepse Kosova nuk është pjesëmarrëse në tregjet globale. Vlen të theksohet, edhe pse Kosova ende nuk ka pasur vlerësim kreditor, Ligji e lejon me qenë pjesëmarrëse, pa marrë parasysh vlerësimin kreditor duke lejuar deri në 30 për qind të aseteve.

Lidhur me vlerësimet e Auditorit të jashtëm për raportimin e Auditorit të brendshëm të IT, kompania që ka qenë e angazhuar nga për me e krye auditimin e brendshëm, nuk ka dorëzuar raport në kohën e mosfunksionalizimit të bordit, ndërsa që tani raporti për vitin 2022 dhe 2023 është i përfunduar.

Mergim Lushtaku, pyeti lidhur me pasivizimin e llogarive, a ka ndonjë analizë se cilët faktorë kanë ndikuar në mbylljen e llogarive, apo është pasojë e mbylljes së bizneseve dhe emigrimit.

Emanuel Bajra, kërkoht në masë të madhe dalja nga mandatet, po që se paragjykojmë vendime politike nga cilado Qeveri që vjen sepse Bordi është vetëm profesional, që përcakton politikat investuese të Trustit dhe nuk komenton vendime politike

Duhet pasur parasysh se tregu është shpërndarë dhe mungesa e opsioneve dhe dinamikave, alternativave, për kontributdhënësit i detyron ata të marrin vendime që do të kanë efekt në politikat fiskale .

Bordi nuk mund të marrë pozicion zyrtar dhe ti rekomandojë Qeverisë apo ndonjë institucioni tjetër vendimmarrës.

Jeta Statovci, rritja e aseteve të Fondit pensional në vitin 2023, për 12.1 reflekton performancë, mbi këtë fakt, ajo pyeti, a ka projeksione për vitin 2024-2025, si e parasheh Bordi trendin e performancës në raport me vitin 2023 konform situatës në përgjithësi.

Emanuel Bajra, pasi tani gjeopolitika ka marrë përpara tregjet financiare lokale dhe kontinentale, është vështirë të bëhen parashikime, nuk mund të pozicionohemi vetëm në një treg, por është më adekuate pozicionimi në një përgatitje 3- 6 muaj se sa në pozicione mbi 6 muaj.

Jeta Statovci, bazuar në raportin, pse është rritur koncentrimi jashtë, ndërsa që kemi zvogëlim të letrave me vlerë të Qeverisë.

Emanuel Bajra, shumica e parave të reja të pranuar nga kontribuuesit duhet të investohen sepse tregu vendor është i limituar dhe ka konkurrencë, fondet mund të bien nëse nuk plasohen.

Jeta Statovci, cilët faktorë kanë ndikuar në rritjen e kontributeve të arkëtuara prej 18.5%.

Adrian Zalli, rritja e pagave dhe rritja e pagave bazë.

Eman Rrahmani, tha se ka dallime në mes shifrave të kontributeve me të dhënat në raport, ndërsa për tabelën që komisionit i adresohet në çdo vit kalendarik, e njëjta të vazhdohet të adresohet për çdo muaj.

Adrian Zalli, në azhurnimin e të dhënave shifrat ndryshojnë.

Kryetari, tha se për ti njoftuar disa anëtarë të komisionit, se në gjashtë vitet e fundit janë mbledhur më shumë se sa që nga themelimi, duke cituar shifrat- në vitin 2023 nga kontributet e arkëtuara janë mbledhur 286 milionë euro, në vitin 2022, 241 milionë, vitin 2021, 213 milionë, vitin 2020, 194 milionë, vitin 2019, 186 milionë, në kalkulim i bien se pati rritje prej 34 për qind.

Sa i përket bilancit të fondeve-llogaritë individuale, në vitin 2023 bilanci ka qenë 2.07 miliardë euro, që është 290 milionë më shumë se në vitin 2022, ndërsa në vitin 2022, 57 milionë euro më shumë se në vitin 2021, ndërsa në vitin 2021, ka qenë 569 milionë euro me shumë se në vitin 2020. Kjo nënkupton që këto arkëtime nuk mund të bëhen me një ekonomi që nuk funksionon, por me një ekonomi të normalizuar dhe funksionale.

Sa i përket investimeve, pyeti se a ka pasur ndryshim pozitiv të udhërrëfyesit në investime?

Emanuel Bajra, ndryshime ka pasur në vitin kalendarik dhe ato janë të publikuara ne ueb faqe

Kryetari, iu propozoi përfaqësuesve të FKPK-së që kërkesat e tyre për strategjinë legjislative t'i adresojnë me shkrim në komision.

Kryetari konstatoi, që pasi nuk pati kuorum, votimi i kësaj pike mbetet për mbledhjen e radhës dhe e mbylli mbledhjen.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00.

E përgatiti: Staf i mbështetës i Komisionit

Armend Muja,

Kryetar i Komisionit